

## Raport Mujor për fondin Credins Pension

Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun, me qëllimin për t'u siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura më të larta dhe të sigurta në moshën e pensionit. Portofoli i Fondit Credins Pension, do të përbëhet kryesisht nga obligacione afatgjata të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Data e raportit: 31.01.2021

### Infomacion për Fondin

Shoqëria Menaxhuese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	01 Janar 2012
Monedha e Fondit:	Lek

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë një cilësi jete gjatë pensionit e cila nuk rezulton më e ulët sesa faza përpara daljes në pension.

### Profili i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët				Rrezik i lartë		
Përfitimet tipike më të ulëta				Përfitimet tipike më të larta		
1	2	3	4	5	6	7

Fondi Credins Pension ka një profil rreziku në nivelin 2, pra të ulët.

### Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	1,112,756,123.25
Çmimi i kuotës	1,520.3707
Numri i investitorëve	17,643
Kthimi nga investimi (31.01.2020 -31.01.2021)*	2.83%

\* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

### Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond

#### Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë aseti përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e riçmimit në momentin e maturimit të saj.

Rreziku i riçmimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

### Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asete janë të emetuara nga Qeveria agjensitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti ("rating") të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

### Kostot dhe Pagesat


Pagesat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të Fondit. Pagesat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit..

Pagesa e hyrjes	0%
Pagesa e daljes	0%
Pagesa vjetore	Tarifa e Administrimit 3% në vit e Vlerës Neto të Aseteve
Kosto transaksioni	0 %
Tarifa e performancës	0%


### Shpërndarja e Instrumentave si përqindje e Vlerës Neto të Aseteve (NAV)

Shpërndarja e Instrumentave	ALL	%NAV
Obligacione	1,093,181,647	98%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	22,668,962.32	2%

## Shpërndarja e Instrumentave sipas Llojit




## Kthimi vjetor neto historik



## Ankandet e titujve qeveritarë dhe normat e interesi

Qeveria e Republikës së Shqipërisë emeton letrat me vlerë në periudha relativisht të rregullta dhe të shpeshta. Në përputhje me materialet informuese të publikuara nga Ministria e Financave, duke përjashtuar ankandet e obligacioneve 2-vjeçare të cilat zhvillohen një herë në muaj, ankandet e obligacioneve të tjera (3,5,7,10-vjeçare) zhvillohen me një frekuencë të përafërt prej 3 muajsh.

### Ecuria e yield-eve të Obligacioneve



Gjatë muajit janar yield-i i obligacionit me afat maturimi 2 vjet u rrit nga 2.55% në 2.63%. Ankandi i rihapjes i obligacionit 5-vjeçar referencë u rrit nga 4.20% në 4.22%. Obligacioni i ri me afat maturimi 10-vjet u rrit nga 5.34% në 5.38%. Gjatë muajit janar nuk u zhvilluan ankande për obligacionet 3 dhe 7-vjeçare.

*Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë [www.credinsinvest.com](http://www.credinsinvest.com)*